

REPubLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Ministri

Nr. 719/2 Prot.

Tiranë, më 14.02.2014



MIRATOHET

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

KARTA E PERFORMANCËS SË SHKOLLËS

I. Kuptimi dhe përdorimi i Kartës së Performancës së Shkollës

Karta e Performancës së Shkollës është një sistem i projektuar për informacion dhe dobishmëri. Karta e Performancës së Shkollës ofron të dhëna për arritjet e shkollës gjatë një viti shkollor. Ajo garanton cilësinë e ofertës së shkollës përmes treguesve të standardizuar dhe shërben si instrument për vetëvlerësimin e shkollës dhe inspektimin.

Karta e Performancës së Shkollës u shërben prindërve, drejtuesve, mësuesve, nxënësve, DAR/ZA-ve, komunitetit dhe gjithë të interesuarve, të analizojnë dhe krahasojnë rezultatet e shkollës me tregues të ndryshëm të arritjeve në një dokument lehtësisht të përdorshëm.

Njohja me rezultatet e treguesve do të ndihmojë prindërit dhe komunitetin të gjykojnë për arritjet dhe nevojat për përmirësim, duke mundësuar një përfshirje reale edhe në vendimarrje.

DAR/ZA-të mund ta përdorin Kartën e Performancës së Shkollës për të analizuar arritjet e shkollave në nivel rajonal, sipas treguesve të paraqitur në kartë, duke evidentuar shkollat me rezultate më të mira si dhe ato që në disa tregues kanë nevojë për përmirësim.

Ky vlerësim reflektohet nga DAR/ZA-ja në hartimin e planeve të veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe prioriteteve të MAS-it, në përputhje me kontekstin lokal.

Drejtuesit e shkollave e përdorin Kartën e Performancës së Shkollës si pikënisje për një analizë të thellë që do të shërbejë si mbështetje për hartimin e planit vjetor të shkollës dhe vlerësimin objektiv të punës së tyre.

Shkollat, të cilat paraqiten me arritje më të mira për tregues të veçantë, mund të shërbejnë si modele praktikash të suksesshme.

Karta e Performancës së Shkollës do të jetë nxitëse për metoda më cilësore dhe bashkëkohore për vlerësimin e punës në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, nëpërmjet krahasimit të shkollës me veten dhe me shkollat e tjera të të njëjtit rajon.

Karta e Performancës së Shkollës sinjalizon një epokë të përgjegjësive shkollore që nderon punën komplekse të shkollave dhe përqendrohet në sigurimin e një shërbimi cilësor të ofruar për nxënësit dhe prindërit.

II. Parime të përgjithshme

- Karta e Performancës së Shkollës përdoret nga shkollat publike dhe jopublike;
- janë të përvitshëm matja e treguesve të përfshirë në Kartën e Performancës dhe vlerësimi;
- bëhet publike për përfituesit e shërbimit arsimor (prindërit, nxënësit, mësuesit dhe komunitetin);
- vlerësimet e Kartës së Performancës së Shkollës përdoren për krahasim dhe renditje në nivel rajonal.

III. Plotësimi i Kartës së Performancës së Shkollës

Shkolla është përgjegjëse për plotësimin e kartës së saj, mbështetur në burimet e mëposhtme:

- të dhëna statistikore të siguruara nga shkollat;
- të dhëna nga testet në nivel rajonal;
- të dhëna nga provimet në nivel kombëtar;
- të dhënat e pyetësorëve të zhvilluara në nivel rajonal.¹

¹ Numri i të anketuarve për një shkollë bazohet në teorinë e statistikës matematike.

IV. Mbi treguesit e Kartës së Performancës së Shkollës²

1. Karta e Performancës së Shkollës përmban tregues të matshëm, objektivë, të verifikueshëm dhe të kuptueshëm (edhe për jo profesionistët) në fushat e kurrikulës së përvetësuar (vlerësimi i arritjeve të të nxënësve), kurrikulës së zbatuar, menaxhimit të shkollës, zhvillimit të burimeve njerëzore, klimës dhe etikës, kujdesit ndaj nxënësve.
2. Sistemi i treguesve përbëhet nga:
 - treguesit e standardizuar qendrorë, të cilët janë të përbashkët për të gjitha shkollat;
 - një numër treguesish lokalë, të cilët caktohen nga njësi përkatese arsimore vendore, sipas ndjeshmërisë lokale arsimore.
3. Treguesit qendrorë dhe ata lokalë mund të ndryshohen sipas përparësive të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (p.sh. nëse, për një periudhë shpallet si përparësi forcimi i rolit të bordit të shkollës, shtohen ose detajohen tregues të matshëm për performancën e bordit).
4. Treguesit klasifikohen në:
 - a) tregues të siguruar nga shkolla dhe të dërguar zyrtarisht në DAR/ZA (ata tregues që nxjerrin në pah arritjen, p.sh. "përqindja e largimeve nga shkolla");
 - b) tregues të vlerësuar nga të dhënat e pyetësorëve;
 - c) tregues të ndryshimeve të dy viteve të njëpasnjëshme (ose krahasuese);
 - d) tregues që matin ndryshimin mes vlerave të arritura nga shkolla me ato në nivelin kombëtar (p.sh. për treguesin nota mesatare e arritur nga shkolla për një nga provimet e Maturës Shtetërore, do të vendoset në Kartën e Performancës edhe nota mesatare e arritur nga shkolla).
5. Tek Karta e Performancës së Shkollës, përveç vitit të parë shkollor të përdorimit të saj, në vitet pasuese shtohen treguesit që matin vlerat e shtuara për vitet e fundit (p.sh., përveç treguesit "Përqindja e braktisjes së shkollës", shtohet edhe "Ndryshimi i përqindjes së braktisjes së shkollës në krahasim me vitin/vitet paraardhëse").

V. Mbi renditjen e shkollave

1. Renditja e shkollave bazohet në vlerësimin e matjeve sipas treguesve.
2. Renditja shpallet për secilin tregues dhe në tërësi. Grafikë të ndryshëm dëshmojnë për nivelin e arritjeve përfundimtare për secilin tregues dhe në total për shkollat.
3. Shkollat renditen veç për arsimin bazë dhe veç për arsimin e mesëm të lartë.
4. Renditja e shkollave bëhet në nivel DAR/ ZA-je.

² Hartimi i Kartës së Performancës së Shkollës do të shoqërohet dhe me udhëzuesin, i cili do të përshkruajë metodikën e punës për matjen e arritjeve sipas treguesve.

VI. Përmbajtja e Kartës së Performancës së Shkollës

a) Të dhëna të përgjithshme për shkollën

(nuk bëjnë pjesë në treguesit për renditjen e shkollës)

Në fillim të Kartës së Performancës paraqiten disa të dhëna të përgjithshme për shkollën që lidhen me:

- DAR/ZA-në, në të cilën bën pjesë shkolla;
- emrin e shkollës;
- numrin e nxënësve;
- karakteristika sociale dhe demografike të shkollës;
- veçori të shkollës (modulet e veçanta, gjuhët e huaja që ofron etj.);
- përqindjen e kalueshmërisë së arritur në muajin qershor;
- notën mesatare të arritur në muajin qershor;
- synimet e planit afatmesëm të shkollës;
- objektivin/objektivat e planit vjetor aktual;
- transparenca financiare (buxheti i shkollës për vitin shkollor);
- adresa elektronike e shkollës;
- vlerësimi i marrë nga shkolla, nëse ajo është inspektuar atë vit nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

b) Treguesit e Kartës së Performancës së Shkollës

▪ Kurrikula e përvetësuar

Arritjet e nxënësve në Provimet e Lirimit/ Maturës Shtetërore

- Përqindja e nxënësve kalues në Provimet e Lirimit/Maturës Shtetërore.
- Nota mesatare e shkollës në Provimet e Lirimit/nota mesatare të shkollës në provimet e Maturës Shtetërore gjatë pesë viteve të fundit.
- Diferenca ndërmjet vlerësimit të Provimeve të Lirimit dhe vlerësimit të këtyre lëndëve në përfundim të klasës së nëntë si dhe të Maturës Shtetërore dhe vlerësimit të këtyre lëndëve në përfundim të klasës së dymbëdhjetë.
- Përqindja e grup-notave 5-6, 7-8, 9-10 për të gjithë nxënësit e shkollës në Provimet e Lirimit dhe Maturës Shtetërore krahasuar me përfundimet vjetore.
- Mesatarja e notës në lëndët përkatëse në Provimet e Lirimit dhe Maturës Shtetërore dhe renditja në nivel rajonal.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në testet e zhvilluara nga Njësia Arsimore Vendore

- Vlerësimi i shkollës për klasat I-III në provimin e zhvilluar nga DAR/ZA-ja.
- Nota mesatare e shkollës në provimet e zhvilluara nga DAR/ZA-ja (për arsimin bazë dhe gjimnazin).
- Diferenca midis vlerësimit vjetor dhe testeve të zhvilluara në nivel rajonal dhe renditja e shkollave.

▪ Kurrikula që zbatohet

- Mbajtja parasysh e parapëlqimit të nxënësve në lëndët me zgjedhje (pyetësi me nxënësit).
- Vlerësimi i ecurisë së shkollës për klasat për tri vite, në fund të klasave 9 dhe 12 në lëndët:
 - gjuhë shqipe, matematikë, gjuhë e huaj.
- Numri i projekteve që shkolla fiton në nivel kombëtar ose ndërkombëtar.
- Numri i fituesve të shkollës në konkurrimin që shpall MAS-i.
- Numri i fituesve të shkollës në konkurrimin që shpall DAR/ZA-ja.
- Përqindja e nxënësve fitues në tri preferencat e para në konkurrimin për studimet universitare.

▪ Menaxhimi i shkollës

- Realizimi i objektivave të planit vjetor për dy vitet e fundit.
- Funksionimi i organizmave në shkollë, si: Drejtoria e Shkollës, Bordi i Shkollës, Këshilli i Mësuesve, Ekipi Lëndor, Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, Komisioni i Disiplinës, Shërbimi Psiko-social, Qeveria e Nxënësve (pyetësi me nxënësit, prindërit).
- Përqindja e orëve të munguara nga mësuesi, kundrejt të gjitha orëve mësimore të një viti shkollor.
- Shkalla e pjesëmarrjes së nxënësve në veprimtaritë e zhvilluara nga shkolla (pyetësor me nxënësit).
- Përqindja e orëve të munguara nga nxënësit, kundrejt të gjitha orëve mësimore të një viti shkollor.
- Përqindja e nxënësve të larguar nga shkolla, kundrejt nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor.
- Përqindja e nxënësve të cilët kanë marrë masë disiplinore.
- Numri mesatar i krediteve të fituara nga punonjësit arsimorë të shkollës (drejtues, mësues) në tri vitet e fundit shkollore.
- Rezultatet e mësuesve në provimet e kualifikimit në pesë vitet e fundit.

- Përqindja e pjesëmarrjes së drejtuesve/mësuesve në rrjetet profesionale.

▪ **Klima dhe Etika dhe kujdesi ndaj nxënësit**

- Përkujdesja për shëndetin, sigurinë e nxënësve dhe punonjësve arsimorë. Kushtet ekologjike, të higjienës dhe pastërtisë në mjediset e shkollës (pyetësi me nxënësit, prindërit, mësuesit).

- Krijimi i një mjedisi psiko-social që synon eliminimin e dhunës (fizike, psikologjike) dhe sjelljeve të rrezikshme (pyetësi me nxënësi, prindërit, mësuesit).

- Përkujdesja ndaj nxënësve me vështirësi në të nxënë ose me nevoja të veçanta (fëmijët me aftësi të kufizuara, romë, egjiptianë, emigrantë etj.), me prirje të veçanta (pyetësi me nxënësit dhe prindërit).

- Shkalla e kënaqësisë së nxënësve nga puna e shkollës (pyetësi me nxënësit).

- Shkalla e kënaqësisë së mësuesve nga puna në shkollë (pyetësi me mësuesit).

- Shkalla e kënaqësisë së prindërve nga puna e shkollës (pyetësi me prindërit).

c) **Shënime të përgjithshme për treguesit**

- Numri i treguesve të mësipërm të Kartës së Performancës së Shkollës do të mund të pakësohet ose shtohet në sajë të konsultimit me përfaqësues të grupeve të interesit (prindër, nxënës, mësues, drejtues të shkollave dhe specialistë arsimit), si dhe pas pilotimit në DAR/ZA-të e caktuara.

- Pjesa më e madhe e treguesve të mëposhtëm vlejnë për renditjen objektive, mbështetur në arritjet e shkollave. Treguesit që nuk do të merren në konsideratë për renditjen janë shoqëruar me një shënim të posaçëm.

- Për një pjesë të treguesve të dhënat sigurohen nëpërmjet pyetësorëve me nxënësit, prindërit dhe mësuesit.

- Për vitin e parë të zbatimit të Kartës së Performancës, numri i treguesve mund të jetë më i paktë se në vitet pasuese, duke e konsideruar vitin e parë si një periudhë reflektimi të mbarëvajtjes së Kartës së Performancës.

VII. Ndryshimi midis Kartës së Performancës së Shkollës dhe shqyrtimeve të tjera të performancës së shërbimit arsimor në nivel shkolle

Karta e Performancës plotëson sistemin e raportimeve që funksionojnë sot në sistemin tonë arsimor.

-Inspektorati Shtetëror i Arsimit shqyrton performancën e institucioneve arsimore (kopshte/shkolla) mbi bazën e një manuali për profesionistët ku zbërthen imtësisht të gjitha aspektet e cilësisë së mësimdhënies, administrimit dhe menaxhimit të shkollës.

-Agjencia Kombëtare e Provimeve vlerëson arritjet e nxënësve nëpërmjet provimeve kombëtare të përgjithshme dhe ato me kampionim. Renditja në nivel kombëtar e shkollave të mesme të larta, mbështetur në rezultatet e Maturës Shtetërore, bëhet çdo vit me ceremoni.

-Titullarët e Njësive Arsimore Vendore vlerësojnë çdo dy vjet performancën e drejtorit të shkollës sipas një bashkësie treguesish.

-Shkollat zbatojnë një procedurë të standardizuar të vlerësimit të brendshëm që është një vetëvlerësim i përvitshëm, i zhvilluar në institucionin arsimor dhe që kryhet në nivel individual (drejtori, nëndrejtori, mësuesi) dhe në nivel organizmesh të shkollës (drejtoria, këshilli i mësuesve, ekipet lëndore).

-Drejtuesit e shkollës vlerësojnë çdo vit performancën e mësuesve sipas një bashkësie treguesish.